

Kultura

Peqini njihet si qytet i vjetër dhe tepër i pasur me vlera kulturore. Ky fakt dëshmohet nga sarajet apo pashallëku që ka pasur dikur Pashai i Peqinit. Akoma edhe sot kanë mbetur pjesë të këtij pashallëku të vogël. Peqini shquhet për kulturë dhe art. Ndonëse i vogël si qytet, nga ky vend kanë dalë figura që kanë lënë gjurmë në histori. Ata janë njerëz që kanë mundur të realizojnë ëndrrat e tyre mëdha, që kanë dhënë shpirt për hirë të dijes së tyre, por jo vetëm. Vlen të përmendim këtu qytetarë si Ferdinand Deda (Artist i Merituar) dirigjenti i parë i Orkestrës Simfonike të Radiotelevizionit Shqiptar, Rifat Teqja (Artist i Popullit) dirigjent i Orkestrës së Operas dhe Baletit, Behije Çela, aktore dhe ish këngëtare e radio Tiranës e shumë figura të tjera.

Peqinasit kanë qenë pjesmarrës në shumë ngjarje historike të rëndësishme në të cilat kanë dhënë kontribut, duke nisur nga shpallja e pavarësisë, Luftën e Vlorës, Kongresi i Lushnjës e deri në Luftën e Dytë Botërore.

Ndërkohë Peqini ruan një traditë edhe në muzikë e veshje popullore. Ato

kanë ngjashmëri me traditën e Elbasanit. Por kjo trevë ka ndikime edhe nga Lushnja, Tirana dhe Kavaja. Disa nga këngët e vjetra popullore janë: “Do shkoj lala në Peqin”, “Mu ke ara tek tagjia”, “Kno moj qyqe se na erdh behari”, vallja e Peqinit etj.

Ndërsa veshjet popullore janë karakteristike të zonës; gratë mbajnë veshur jelek, këmishë të qëndisur dhe burrat xhamadan e qeleshe të bardhë. Mjaft e njohur është vallja e Peqinit.

Ky qytet mbart vlera të rralla të trashëgimisë kulturore dhe historike. Pozicioni gjeografik e ka favorizuar që të jetë stacion i rëndësishëm përgjatë rrugës së lashtë Egnatia, pikë tranziti mes Lindjes e Perëndimit.

Ulliri konsiderohet si druri më me vlerë që e ka origjinën nga lashtësia. Sipas legjendës në Klaudianë kishte aq ullinjtë saqë, kur u ndërtua rruga “Egnatia” në të dy anët e saj u vendosën edhe tubacione për rrjedhjen dhe depozitimin e vajit në Dyrrah.

Përsa i përket vlerave ushqyese ulliri i Peqinit zë vend të parë në Shqipëri, por sipas të dhënave edhe në Mesdhe. Fatkeqësisht disa nga këta ekzemplarë ndodhen në zhdukje e sipër, për shkak të vjetërsisë së tyre.

Një tjetër ngjarje e rëndësishme për Peqinin është “Thesari i Vrapit”, i cili është zbuluar në fillim të shekullit të kaluar nga katër banorë të fshatit Vrap. Ai përbëhet nga 6.5 kg ar dhe 1.5 argjend. U shit dorë më dorë dhe sot ndodhet në një muze në ShBA. Por Peqini ka tradita të mëdha edhe në sport. Skuadra e Shkumbinit është krijuar në vitin 1929 dhe vazhdon ta ruajë këtë traditë.

